



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 30759/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Fitim Selimi nga fsh. Banull K. Prishtinë, për kundërvajtje nga neni 8 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-050 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1.pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt.31.12.2012 merr këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtës kundër të lartcekurit Fitim Rrahim Salihu i lindur me 1960 në fsh. Banull ku dhe tani jeton, për kundërvajtje nga 8 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-050 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar Konform neni 198 al.1 pik. 8 të LMK-es Pezullohet Procedura ,pasi qe nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrori kërkesën nr. 01-2496/2012 të dt. 03.07.2012, për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të lartpërmendurit e për kundërvajtjen e lartcekur,ku është marr konkluzion. Ne baze të kërkesës u murr në pyetje i lartpërmenduri I cili pohoj se sa i përket kërkesës të cilën e ka ushtruar Agjensioni Anti Korupsion për mos deklarimin e pasurisë është fakti se unë nuk kam qenë i informuar dhe nuk e kam pranuar kufar njoftimi përmes imelles apo formulari, ngase në fillim edhe agjensioni shihet se e ka filluar procedurën me emrin "Fitim Salihu" kështu qe këto gabime mund të jenë shkak qe ndoshta mua nuk me ka ardh imell adresa, dhe për shkak të këtyre gabimeve unë nuk mund të jem përgjegjës për shkak se nuk më është dërguar kufar njoftimi as për mes imelles, as përmes dërgimit të formularit në mënyrë fizike, ku mund të shihet se në listës e emrave të cilën ju ka dërguar agjensioni për personat të cilët kanë pas ta paraqesin deklarimin e pasurisë përmes imell adresës shihet se askund nuk është emri im, dhe si ka mund e me dregohet mua, për mbushjen gjegjësisht për deklarimin e pasurisë, dhe për shkak të kësaj rrethanë unë nuk kam pas kufar njoftimi qe ta mbushi këtë formular, ku ekzistojnë edhe rrethanat e tjera, ku unë këtë funksion e kam prej janarit 2011 në kohë zgjatje prej 3 vite por me vendim të veçan të bordit për shkak të impaktit financiar për ndërmarrjen, përcaktohet prezenca e jonë në takim të bordit për periudhën kohore 6 muaj në ndrimin me perfasuesin e Drenasit.

Sipas kërkesës se ushtruar marrjes në pyetje të pandehurin dhe prova të tjera të administruar në lënd, gjyqtari konfome neni 198 al.1 pik. 8 të LMK-es e PEZULLOI procedurën kundërvajtëse ndaj të lartpërmendurit. pasi qe nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë brenda 8 ditësh pas marrjes së të njejtit përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Gjyqtari për kundërvajtje
Fatmir Behrami

